



BURSA PËR KURSIN VEROR TË GJUHËS, LETËRSISË DHE KULTURËS ÇEKE

Në kuadër të Programit *“Summer Schools of Slavonic Studies in 2018”*, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve e Republikës së Çekisë ofron 2 (dy) bursa për pjesëmarrje në kurset verore të gjuhës, letërsisë dhe kulturës çeke të studentëve, mësuesve dhe specialistëve shqiptarë. Kurset do të mbahen për një periudhë intensive 4-javore në tri nivele (fillestar, i mesëm dhe i avancuar) pranë Universitetit të Karlit (Charles University) në Pragë në datat 27 korrik - 24 gusht 2018 (<http://lss.ff.cuni.cz/en/lss.praha@ff.cuni.cz>) dhe pranë Universitetit Masaryk në Brno në datat 21 korrik - 18 gusht 2018 (<http://www.phil.muni.cz/kabcest/en/summer-school.php>)

Kandidatët e interesuar për kurset e mësipërme duhet të dërgojnë me postë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtorisë së Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës, brenda datës **23 shkurt 2018**, dokumentacionin përkatës sipas listës në vijim:

1. Kërkesën për ndjekjen e kursit veror të gjuhës çeke;
2. Formularin e aplikimit (mund të shkarkohet në <http://www.msmt.cz/file/45396/>);
3. Kopjen e noterizuar të diplomës ose të ndonjë dokumenti të ngjashëm që vërteton mbarimin e programit të studimit të nivelit I dhe II të studimeve të larta ose pasuniversitare;
4. Kopjen e noterizuar të Supplementit të Diplomës ose të listës së notave;
5. Vërtetim nga universiteti përkatës për aplikantët që ndjekin aktualisht studimet universitare/pasuniversitare;
6. Fotokopjen e faqes së pasaportës me të dhënat e identitetit;
7. 2 (dy) fotografi.

Për kurset e mësipërme preferohen kandidatë që kanë njohuri bazë të gjuhës çeke.

Pala çeke përballon shpenzimet për ushqimin, akomodimin dhe programin mësimor dhe kulturor, ndërsa shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje do të mbulojnë nga vetë pjesëmarrësit e kursit.

Për një informacion më të hollësishëm për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, ju lutemi referojuni adresës në web-site:

<http://www.msmt.cz/eu-and-international-affairs/summer-schools-of-slavonic-studies>;

Bashkëlidhur këtij njoftimi ndodhet formulari i aplikimit.

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT,
MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS**